



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 13.03.2015, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkryetarin e komunës z. Xhemali Haxhimustafa, komandantin e stacionit policor në Rahovec z. Osman Ismaili, anëtarët e KPF-së, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, përfaqësuesit e medieve dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informim mbi punën e Stacionit Policor Rahovec për vitin 2014,
3. Shqyrtimi i Propozimit për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e pronës private për nevojat e shkollës fillore "Ardhmëria" në Rahovec,
4. Shqyrtimi i Propozimit për shlyerjen e borxheve 50% e të gjithë qiramarrësve të pasurisë komunale,
5. Të ndryshme.

Rendi i ditës aprovohet unanimisht.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Procesverbali aprovohet pa vërejtje.

2. Informim mbi punën e Stacionit Policor Rahovec për vitin 2014..

Osman Ismajli, Komandant i stacionit policor në Rahovec – Fillimisht në emër të gjithë stacionit policorë në Rahovec dhe në emrin tim personal dua të ju falënderoj dhe ju përgëzojë për kontributin dhe angazhimin tuaj për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë gjatë vitit 2014, çështje kanë të bëjnë të gjitha me nivelin e sigurisë së qytetarëve të komunës sonë pastaj parandalimin dhe luftimin e çdo dukurie negative gjatë vitit të kaluar, pavarësisht praktikave të paraardhësve të mi është obligim ligjor i menagjmentit të këtij stacionon të jetë ma transparentë dhe të bashkëpunoj sa më ngushtë me ju të gjithë pa dallime, ne i referohemi obligimit ligjorë për informim të përhershëm kryetarit të komunës çdo ditë për të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet e policisë së Kosovës në komunën tonë, informacionet i japim në mënyrë elektronike çdo ditë por kemi edhe kontakte të shpeshta me kryetarin e komunës, kryetari i komunës një herrit është edhe kryesues i këshillit komunal për siguri në bashkësi misioni i këtij forumi është të gjitha problemet dhe brengat e qytetarëve të komunës në cilat kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe çështjet e tjera, për këto çështje ekzistojnë edhe 2 forume të tjera, Komiteti për siguri publike i cili përfshinë qytetin e Rahovecit dhe fshatin Hoçë e Madhe pra është multi etnike ku marrin pjesë edhe pjesëtarët e pakicave, përveç kësaj është i formuar edhe një ekip veprues për Siguri në Bashkësi i cili vepron për tërë territorin e komunës së Rahovecit dhe janë të përfshira të gjitha strukturat e duke filluar prej udhëheqësve të fshatit, udhëheqësve politik, bizneseve, shkollat, OJQ, shoqëria civile etj. Stacioni policorë në Rahovec vepron si njësi organizative në kuadër të drejtorisë rajonale të policisë të Gjakovës prej 01.01.2015, ky kalim është bërë konform ligjit mbi kalimin e gjykatave të rregullta në Kosovë dhe kompetencës territoriale të gjykatës themelore në Gjakovë, stacioni policorë në Rahovec numëron gjithsej 73 punonjës prej tyre të uniformuar janë 59 dhe staf civil 14, bazuar në strukturën Organizative të policisë së Kosovës dhe kategorizimin e këtij stacioni për momentin ky njësi funksionon me mungesë të madhe të stafit të uniformuar afër 30% është e paraparë me këtë strukturë të ketë ky stacion policorë deri në 87 punëtorë të uniformuar, përveç mungesës së stafit ballafaqohemi edhe me mungesë të madhe

pajisjeve logjistike, mungesë të automjeteve, të pajisjeve kompjuterike, pajisjeve forenzike si dhe pajisjeve tjera për kontrollin dhe kontrollimin rrugor. Objektivat e parapara për policinë e Kosovës janë kryesisht: Mbrojtja e rendit Kushtetues, Rendi dhe sigurisë publike në Kosovë, Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, Parandalimi ndjekja dhe zbulimi i krimit, Krimit të organizuar dhe korrupsionit, Ngjitja e nivelit të tolerancës dhe bashkëjetesës ndëretnike, Ngjitja e nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor, Parandalimi i incidenteve të tjera në shkollat etj, përveç implementimit dhe realizimit të këtyre objektivave ky stacion në bashkëpunim me institucionet e tjera komunale dhe ato të nivelit qendror është i angazhuar edhe në luftimin e dukurive negative të cilat kanë të bëjnë më së tepërmi me mbrojtjen e ambientit siç janë: Eksplantimi i egër i rrëzës dhe zhavorrit në shtratin e lumit Drin, degradimi dhe eksplantimi masovik i pyjeve, dëmtimet dhe vjedhjet permanente në trasenë hekurudhore Krushë e Madhe Mrasorë me gjatësi prej 30 km, hedhja e mbeturinave vend e pa vend në të gjitha hyrjet e qytetit dhe vendbanimet tjera në komunën tonë të cilët paraqesin edhe rrezik permanent për sëmundjet e ndryshme, rrezik nga qentë endacak etj.

Rendi dhe Qetësia Publike - Gjatë vitit 2014 janë regjistruar gjithsej 40 raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike ndërsa në vitin paraprak 2013 kanë qenë 34 raste, pra një përqindje e vogël ka qenë në rritje, prishje masive të rendit dhe qetësisë nuk ka pas, konflikte ndëretnike masovike nuk ka pasur përveç rasteve individuale, është mbajtur një protestë dhe dy tubime me karakter homazhi në shenjë të përkujtimit të vrasjes së deputetit Pista, duhet veçuar edhe mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të muajit qershor të cilët kanë qenë ndër zgjedhjet ma të qeta dhe më demokratike të pas luftës në Kosovë.

Kriminaliteti – Bazuar në statistikat vjetore të vitit 2014 sikurse në tërë territorin e republikës së Kosovës prinë për nga numri i veprave penale kundër pasurisë siç janë : Vjedhjet e rënda, vjedhjet dhe dëmtimi pronës, pjehtë sulmi i këtyre vjedhjeve janë kryesisht shtëpitë e pa banuara, Dyqanet, veturat dhe pajisjet tjera teknike, gjatë vitit 2014 janë raportuar gjithsej 596 raste ndërsa në vitin 2013 kanë qenë 648 këtu kemi një rritje për 9 % ma pak, përqindja e zbulueshmërisë për vitin 2013 ka qenë 67% ndërsa në vitin 2014 ka qenë 75% pra edhe këtu kemi një rritje prej 18%, do ti prezantojë tash statistikat më të rënda të rasteve të veprave penale, në 2013 nuk kemi pas asnjë vrasje, ndërsa në 2014 kemi pas 2 vrasje, Lëndim të rëndë truporë në 2013 kemi pas 12 raste në 2014 vetëm 4 raste, Vjedhje në 2013 kanë qenë 77 ndërsa në 2014 78 raste, vjellje të rënda 83 2013 ndërsa në 2014 kanë qenë 85, grabitje në 2013 kanë qenë 5 ndërsa në 2014 kanë qenë 1, incidentet ndëretnike nga minoriteti serbë janë raportuar gjithsej 6 raste, 3 raste të shkruarjes së grafikëve dhe 3 raste dëmtimi pasurisë, prej këtyre rasteve 3 janë të zbuluara dhe 3 janë në procedurë të hetimit, dhunë në familje gjatë vitit 2013 janë raportuar gjithsej 18 raste ndërsa gjatë 2014 janë raportuar 15 raste, tek dhuna në familje kryesisht kemi të bëjmë me kërcënime, dhunë psikike, lëndime trupore etj, kryesisht viktimat janë bashkëshortët dhe në shumicën e rasteve femrat dhe fëmijët dhe në shumë raste edhe anëtarët e tjerë të familjes si vëllezërit, motrat etj.

Incidentet në shkolla gjendja e sigurisë dhe e rendit në 41 shkolla në shkolla fillore dhe të mesme është e mirë dhe stabile edhe përkundër të disa incidenteve të izoluar, mësimin në këto shkolla e vijnë gjithsej 12,856 nxënës, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe rendit në këto shkolla policia e Kosovës gjatë vitit 2014 ka implementuar shumë projekte në këto projekte janë përfshirë gjithsej 16 shkolla fillore në fshatra dhe qytet të cilat kryesisht gravitojnë në afërsi të rrugëve rajonale dhe magjistrale dhe nëpër rrugë kryesore të qytetit, në ligjëratat dhe punë praktike rregullimi i trafikut me nxënës janë përfshi rreth 2.350 nxënës nga klase e 1 deri në klasën e 9, demat që kanë dominuar kryesisht janë delikuenca e të miturve pastaj siguria e nxënësve në trafikun rrugor, parandalimi i dukurive tjera negative nëpër shkolla siç janë pirja e alkoolit, drogës dhe sjelljet e tjera devijante, është i domosdoshëm bashkëpunimi ma i mirë në mes të prindërve, mësimdhënësve dhe institucioneve tjera relevante që në bashkëpunim me policinë e Kosovës ti risim këto aktivitete edhe me projekte të ndryshme duke i përfshirë mediet, shkollat, drejtorinë e arsimit, OJQ, shoqërinë civile dhe qendrën rinore.

Komunikacioni Rrugorë – Niveli i sigurisë i gjitha kategorive të rrugëve magjistrale, rajonale dhe rrugë lokale ka qenë e mirë, rrugët janë të ngarkuar kryesisht në sezonin veror gjatë muajit qershor dhe gushtë kjo është periudha e sezonit turistik dhe kthimit të bashkatdhetarëve në vendlindje për pushime verore, kemi një fluks të madh të automjeteve po ashtu edhe gjatë festave të fundvitit që edhe në këtë kohë kthehen po ashtu bashkatdhetarët tanë në vendlindje, pastaj ngarkesë në trafik kemi po ashtu gjatë procesit të mësimit në mëngjes kur nxënësit qarkullojnë dhe pastaj në mesditë dhe në mbrëmje, rrugët gjatë sezonit rrugorë kanë qenë të mirëmbajtura dhe të pastruara nga dëbora nga kompanitë përgjegjëse duku ka pasur vështirësi dhe ngecje për shkak të teknikës jo

adekuate të cilën e disponojnë kompanitë mirëpo brenda 24 orëve është arritur çdo ku pamvarsisht terrenit dhe konfiguracionit që është i vështirë në disa fshatra e kemi Zatriqin, Koznikun dhe disa fshatra tjera mirëpo është arritur që qytetarët të qarkullojnë lirshëm brenda 24 orëve, gjendja e infrastrukturës rrugore në komunën tonë është e mirë por me disa dëmtime posaçërisht në rrugën rajonale Gradishë-Ratkovcë-Kramovikë dhe atje kemi më së tepërmi aksidente ka mungesë të shenjave vertikale dhe horizontale në të gjitha rrugët mirëpo edhe në qytet shenjat vertikale çdoherë dëmtohen nga personat të pandërgjegjshëm e në disa raste edhe i vjedhin.

Aksidentet e trafikut – Gjatë vitit 2014 kanë ndodhur gjithsej 273 aksidente, aksidente fatale me të vdekur 3, me lëndime të rënda 25 raste të lënduar 37 persona, me lëndime të lehta 75 raste të lënduar 89 persona, si dhe më dëme materiale 170 raste, ndër shkaqet kryesore të aksidenteve janë tejkalimi i shpejtësisë, mospërshtatja e kushteve të rrugës, alkooli, infrastruktura e dëmtuar e rrugëve, pjesëmarrja e madhe e makinave të punës traktorëve, ekskavatorëve në rrugë pa drita në orët e mbrëmjes, po ashtu kemi të bëjmë edhe me nivelin e ulët të edukimit dhe vetëdijë së pjesës ma të madhe të pjesëmarrësve në trafik pa marrë parasysh se a janë në cilësinë e këmbësorëve apo të shoferëve. Gjohat e lëshuar gjatë vitit 2013-2014, gjatë vitit 2013 ky stacion policorë ka shqiptuar 3.190 gjoha ndërsa në vitin 2014 janë shqiptuar 5.500 gjoha pra 72 % kemi pas rritje, kjo është bërë mu për shkak të pasojave në tërë Kosovën ka qenë numri i të vdekurve vitin e kaluar 122 i të vdekurve në trafik 4.000-5.000 i të lënduarve rëndë dhe letë ndërsa për aksidente për dëme materiale mos të flasim, me aplikimin e masës së konfiskimit të dokumenteve patentë shoferëve dhe të lejeve të qarkullimit në periudhën e vitit 2014 e deri me 31 janar 2015 janë paguar në afat rekord 2.700 gjoha vetëm këtij stacioni, kjo shifër është edhe ma e madhe kur të llogarisim edhe trafikun rajonal i cili 2-3 herë ma shumë ka lëshuar gjoha në territorin e komunës sonë, ky stacion ka qenë mjaftë efikase në realizimin e pagesave të gjobave të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejtë në të hyrat e buxhetit komunal, bazuar në statistikat e drejtorisë për financa gjendja e të hyrave është si vijon:Në vitin 2013 gjoha në trafik që janë paguar brenda 15 dite kanë qenë 23.706 €, gjohat që kanë ardhur nga gjykata 90% janë nga dënimet e stacionit policorë kanë qenë 37.321 € pra gjithsej 61.027.00 €, ndërsa në vitin 2014 kjo rritje është bërë 3 herë ma shumë për shkak të konfiskimit të dokumenteve, gjohat në trafik, në këtë vit të hyrat kanë qenë 102,962.00 €, ndërsa gjohat që kanë ardhur nëpërmjet gjykatave kanë qenë 137,212.00 € dhe totali 241,074.00 € këto të hyra shkojnë për investime kapitale në Komunën e Rahovecit, me vendimin e ministrit të brendshëm i nxjerrë në shkurt të këtij viti këto të hyra dhe këto mjete buxhetore do të zvogëlohen 3-4 herë në këtë vit, i vetmi fat është nëse projektligji do të aprovohet në parlamentin e Kosovës dhe ata do ta zgjidhin mënyrën apo procedurën se si do të ekzekutohen këto dënime, sepse kjo ndikon drejtpërsëdrejti në vjetërsimin e lëndëve kështu që diku afër 50 % të lëndëve nëpër gjykatat tona vjetërsohen, gjatë

vitit 2014 janë realizuar 1.700 urdhëresa të lëshuara nga gjykatat dhe prokuroritë e shtetit, persona të atestuar kanë qenë gjithsej 237 të ndaluar në qeli kanë qenë 37 persona.

Lëshime të dokumenteve – Vërtetime për dokumente të humbura janë lëshuar 720, vërtetime për të kaluarën kriminale janë lëshuar 907, vërtetime për paraqitje të vendbanimit 567.

Aktivitetet Operative – Asistimet e gjykatave, Kedsit, Kuvendit të komunës, AKP, ATK, kompanisë radoniqi dhe përmbartësve privatë kanë qenë 42.

Armët dhe municionet e Konfiskuara – Armë të shkurta dhe të gjata 21, municione 238.

Shpenzimet në stacionin policorë – Gjithsej me automjete zyrtare janë kaluar 22,282.00 km pra këto km janë kaluar nga 3 ose 4 vetura sepse ma tepër nuk kemi, derivate të harxhuara për automjete naftë 24.280 Litra, Rrymë 4.872 €, Ujë 447 €, mbeturina 542 €, telefon fiks 1.152 € duke i përfshirë 45 telefona, naftë për gjenerator janë harxhuar 577 litra dhe diku afër 700 €, po ashtu për nxehtë qendrore kemi diku afër 12.000 litra naftë dhe 4.500 € pilet,

Migrimi Ilegal – Policia e Kosovës është në implementimin e projektit qëndro në vendin tuaj i cili projekt ka të bëjë me masat dhe aktivitetet që ka marrë policia e komunitetit në bashkëpunim me institucionet e tjera me qëllim të parandalimit të migrimit ilegal masovik nga Kosova për në shtetet e BE-së, me një largim masovikë posaçërisht gjatë 2-3 muajve të fundit të vitit të kaluar ka vazhduar edhe në janar-shkurt të këtij viti, në komunën e Rahovecit për në shtetet e BE-së bazuar në disa statistika të pa sakta janë larguar disa qindra qytetarë dhe më së tepërmi kemi raste individuale kryesisht të rinjë por ka edhe ma familje dhe grupe, sipas statistikave zyrtare të drejtorisë së arsimit në komunën tonë kanë lënë mësimin në shkollat fillore dhe të mesme gjithsej 72 nxënës, tani për momentin ky fluks ilegal ka rrënjë në minimum për shkak se shtetet e BE-së nuk pranojnë statusin e azilit politik e as ekonomikë, pastaj është forcuar kontrolli i kufirit Serbi-Hungari me angazhimin e policisë të shteteve evropiane në veçanti nga Gjermania, Austria dhe shtetet e tjera të cilat janë në mbështetje të policisë Hungareze dhe serbe.

Disiplina – Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 8 raste të shkeljes disiplinore nga zyrtaret policorë, prej tyre 4 kanë të bëjnë me ankesa të qytetarëve prej të cilëve nga komisioni disiplinorë 3 janë konstatuar si të pa bazuara ndërsa 1 është në procedurë e sipër dhe 4 rastet e tjera janë 2 shkelje të rënda dhe 2 të lehta në 4 rastet zyrtarët policorë janë dënuar dhe ju kanë shqiptuar dënimet.

Të nderuar të pranishëm ju ftoj për një bashkëpunim më të ngushtë me policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante posaçërisht me ato që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë që qytetarëve tanë ti sigurojmë një ambient të qetë dhe të sigurt duke u angazhuar në parandalimin e çdo dukurie negative në shoqërinë tonë.

Selim Duraku – Problem më së shumti kohën e fundit kemi pas tek hedhja e mbeturinave dhe tek qen endacak, janë 2 çështje që i kemi diskutuar edhe në Kuvendin komunal, por nuk kemi mundur ta bëjmë një zgjidhje adekuate. Dua ta di se çfarë roli ka luajtur policia në këto 2 situata. Pyetja e dytë është për sigurinë në shkollë, unë e di që ka pasur shumë raste që në shkollë janë mbajtur nga ana e nxënësve armë të ftohta dhe çfarë masa janë marrë për këtë shkollë.

Osman Ismaili - Territorin e komunës sonë vërtet e kanë vërshtuar mbeturinat, në çdo rrugë çdo lagje, meqenëse ka kompani kompetente që i mbledhin mbeturinat por faji kryesorë është tek qytetarët sepse i hedhin vend e pa vend, sa i përket qeneve endacak kjo është temë diskutimi gjithmonë në mbledhjet e KKSBB ne i pranojmë gjithmonë ankesat e qytetarëve 12 i kemi pas gjatë vitit të kaluar për shkak rizikut nga qenët endacak në këtë vit e kemi pas një rast në Xërxë ku është sulmuar lehtë një qytetar, dyshohet se shifra e këtyre qeneve endacak në komunën tonë është deri në 3.000, është një projekt i vogël nga KLSP që vepron në Rahovec dhe Hoqë ata e kanë bërë një projekt dhe presin një investim të vogël nga jashtë po ashtu edhe kryetari ka paraparë mjete të veçanta për te, ne e kemi një strehimore për qenë në fshatin Nagavc ajo nuk e ka një kapacitet të mjaftueshëm mirëpo sidoqoftë ata janë të gatshëm por nevojiten para sepse trajtimi i një qeni kushton prej 40-70 €, ata që janë për ekzekutim bëhet ekzekutimi me anë të metodave humane sepse me ligj është e ndaluar që të vritet, pritet që të merret një vendim nga qendra ose të ndryshohet ky ligj sepse unë e di se komuna nuk disponon mjete që të paguaj 40-70 € për një qenë. Sa i përket incidenteve nëpër shkollë ne i kemi pas diku afër 7-8 incidente gjatë vitit të kaluar dhe është gjet një armë dhe është konfiskuar po ashtu ka edhe mjete të forta nëpër shkollë ne i respektojmë rregullat pedagogjike statusin e shkollës ne hymë dhe bëjmë bastisje vetëm nëse kërkon drejtori i shkollës apo stafi tjetër mësimdhënës që është prezentë, përndryshe bastisjet më së shpeshti i bëjmë në autobusë, nëpër stacione të autobusëve dhe gjatë rrugës në mënyrë spontane kur kemi informacione se ata kanë armë të nxehta apo të ftohta.

Beatrisa Demiri – Unë vetëm dua të përshëndes bashkëpunimin që ka filluar në mes të policisë dhe shkollave, po ashtu të falënderojë në mënyrë publike komandantin për organizimin e ligjëratave që i kanë bërë kanë qenë shumë të mirëseardhura nëpër shkollë dhe pajisja e nxënësve me disa mjete sinjalizuese. Edhe ju e cekët vetë se po ballafaqoheni me mungesë të mjeteve të ndryshme dhe kjo mungesë e mjeteve në disa raste ndikon tek ju për mos zbulimin e disa veprave deri në fund.

Fatmir Iska – Konsideroj se policia jonë sinjalisht është për lëvdata, sepse i kryen punët mirë me mundësitë që i ka dhe është hera e parë që kemi një prezantim të një raporti ose informate lidhur me punën e Stacionit policor në Rahovec. Komandanti i përmendi në vija të trasha të gjitha problemet që komuna jonë po ballafaqohet duke filluar nga veprat e ndryshme penale që kryhen, migrimit ilegal, shpenzimeve, problemin me qen endacak, sigurimin nëpër shkollë etj.

Rasim Fazliu – Pyes komandantin për rreth rrotullimit që është në hyrje të Rahovecit nga Xërxë, është i vetmi rreth rrotullim që nuk kam siguri kur kaloj, sepse nuk e dimë se kush kujt i jep përparësi edhe pse rregullat e komunikacionit janë të qarta, dhe i kisha bërë lutje të gjithë ata që janë kompetentë qofshin përfaqësues të komunës ose të policisë që të

mirën masat dhe të vendosen shenjat aty ku duhet dhe të rregullohet kjo çështje. Sa i përket raportit të paraqitur jam i kënaqur dhe e falënderoj komandantin.

Osman Ismaili – Të them sinjerisht se edhe ne me makinë të policisë ndalemi aty sepse ai që vije nga Malishevë nuk ndalet, për fat të keq Ministria e transportit dhe drejtoria e rrugëve që e ka projektuar atë rreth e kanë planifikuar gabimisht sepse ai rreth është dashur të devijohet, kanë ekzistuar 2 shenja ma lartë por i kanë asgjësuar gjatë pastrimit të rrugëve ekziston vetëm shenja e trekëndëshit poshtë edhe ai është i shtrembët dhe atë shpesh herë duhet policët ti rivendosin ato shenjat sepse ministria nuk mirët me atë punë fare, unë kam kërkuar nga ministria që të rishikohet projektimi i atij rrethi. Po ashtu e kemi edhe një rreth në qendër shumë anormalë dhe jo logjikë ta devijosh rrugën rajonale dhe rrugën kryesore të qytetit pa nevojë për një rrugë qore është e pa

kuptimit nuk ka pas nevojë kanë qenë trakët ka qenë rreshtimi i veturave, kështu që automjetet e rënda dhe autobusët rrotat e fundit i kalojnë përmbi rreth dhe munden dikë ta shtypin.

Nënkryetari – Komandant të falënderojmë për një raportim dhe informacion të qartë shumicën e pyetjeve që i bëmë janë pyetje që duhet të na interesojnë juve si kuvendarë dhe neve si ekzekutivë, qentë endacakë është problemi ynë, ne ja kemi nisë kësaj punë por ajo strehimore është OJQ dhe OJQ nuk ka drejtë të merë pjesë në tender mënyra tjera të pagesës nuk mundet dhe tash kemi mbetur ose duhet ta shkelim ligjin ose duhet të shkojmë ta marrim një leje se mund të vije auditori dhe të na thotë se si i morët ata dhe ne kemi mbetur në një situatë të keqe dhe qytetari nuk mundet të na kuptojë, çështja e hedhjes së mbeturinave komandanti tha shumë mirë të bëjmë raportin e bashkëpunimit të qytetarëve dhe policisë sepse me 60 njerëz nuk mundet me absorvu, po ashtu edhe mu më shqetësojnë ato fakte që i përmendet ju dhe Rasimi për rreth rrotullimet sepse me të vërtet janë të rrezikshme sepse nuk ekzistojnë shenjat se kush ka përparësi ne e dimë se në rreth rrotullim gjithmonë ka përparësi ana e majtë, mirëpo këtë punë as nuk e ka bërë policia por as neve nuk na ka pyetur askush, por sa i përket këtij rrethi që është në qendër çdo gjë që fillon me rena mbaron me turp, por mua më shqetësojnë 2 gjëra mua si qytetar më shqetësojnë si qytetar zërja e trotuareve dhe unë e di se ju keni pas kritika nga qytetarët kur i largoheshit, tjetër çështje që më shqetëson është çështja e ndalesës së autobusëve nëpër 4-5 pika brenda qytetit posaçërisht ajo te semaforët, unë mendoj se me 5-6 mijë euro mund të bëjmë një zgjidhje nëse kemi nevojë sepse nuk është linje urbane por është ndër urbane, po ashtu shqetësim tjetër është ujëmbledhësit e shiut ju të gjithë keni makina dhe e shihni se sa i bëjnë dëme veturave dhe vetvetes sa kemi rrezikshmëri sepse njerëzit devijojnë nga rruga hypin në trotuar dhe mund të bëjnë ndonjë aksident. është koha që me 20-30 mijë euro ti qesim kamerat nëpër qytet sepse është në interes të të gjithëve kemi pas raste që na kanë nevojitur shumë dhe i kishin zgjidhë shumë probleme.

Osman Ismaili – Sa i përket parkimeve në rrugë dhe në trotuar shpesh herë qytetarët tanë e harrojnë ligjin, ata kanë të drejtë 3-5 min të ndalin makinën dhe ti ndezin 4 indikator por ku është rrugë e hapur por ata nuk i shfrytëzojnë këtë mundësi por e parkojnë veturën në trotuar dhe e bllokojnë rrugën dhe pastaj nuk mund të kaloj as edhe këmbësori, dhe mu për këtë arsye ne i kemi 72 % të dënimeve në rritje, po ashtu është edhe një pamje e vrazhdë dhe që shkakton shumë tollovi edhe ata dyqane të artikujve 1 € që i qesin sendet në rrugë ato lokale që i qesin tepihët dhe karikat nëpër rrugë ne shpesh herë dalim si polici në aksion por duhet ta dine se nuk është vetëm punë e jona komuna i ka edhe inspektorë për këtë punë dhe ne gjithmonë i mbështesim ata për kësi aksione por shpesh herë ne organizojmë aksione dhe i kërkojmë nga ata që të na mbështesin. Po ashtu për pusetat të dëmtuara është e vërtet ne e kemi një praktikë shumë të mirë e qesim patrullën tek vendi e skicon vendin e fotografon dhe fotografitë ja dërgojmë drejtorisë së shërbimeve publike dhe kjo drejtori duhet të mirët pastaj me këtë punë, është e vërtet se para një jave i kanë mbyllur disa gropa mirëpo nuk mjaftojnë posaçërisht këto prerje që janë në tërë shiritin dhe që janë të metalit ato deformohen sepse nuk e kanë kualitetin e duhur dhe bëjnë një zhurmë shumë të keqe dhe banorët që janë afër nuk kanë mundësi as që të flenë natën. Tjetra më keqja që është në ditën e tregut ushqimi i kafshëve që është në shitje parkohet në parkingun e Hotel Plazez dhe një frymë me fry e gjithë kashta shkon nëpër tavolina, unë kisha me propozuar që këtë të futen në ndonjë rrugë qore që nuk i kish penguar askujt.

Kryesuesi – E falënderojmë edhe një herë komandantin, kalojmë në pikën tjetër,

3. Shqyrtimi i Propozimit për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e pronës private për nevojat e shkollës fillore “Ardhmëria” në Rahovec, e përshëndes drejtorin e shkollës Ardhmëria dhe arsimtarë që janë të pranishëm.

Kujtim Popaj, Drejtori i gjeodezisë dhe kadastrës – Përshëndetje për gjithë të pranishmit, Pra kemi të bëjmë me një vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm dhe ka të bëjë me shpronësimin e një prone private e cila xhindet afër shkollës Ardhmëria në Rahovec sipas propozimit të kryetarit dhe kërkesës së drejtorisë për arsim kjo sipërfaqe në të ardhmen do ti nevojitet kësaj shkolle për zgjerimin e oborrit dhe ngritjen e një salle sportive për nevojat e shkollës, pronë private është e vëllëzërve Vekosllav dhe Srećko Milenković me një sipërfaqe prej 45.54 Ari dhe mendojë se kjo sipërfaqe do ta kishte zgjidhur problemin e kësaj shkolle, pas aprovimit të këtij akti nga ana e kuvendit të komunës pastaj duhet të zhvillohen disa procedura tjera që i mbetet ekzekutivit që ti zgjidhë.

Rexhep Oruçi – Mendoj se edhe propozimi edhe ideja është shumë e qëlluar sepse shkolla Ardhmëria nuk ka as oborr përveç shkallëve dhe mendojë se kjo hapësirë do ti shërbej edhe për aktivitete sportive por do të shërbej edhe për oborr për këtë shkollë që është shumë i nevojshëm, unë e përkrahi këtë propozim vendim.

Fatmir Iska – Unë mendoj se është një ide shumë me vend dhe atë që e përmendi Rexhepi qëndron edhe për shkak të konfirigacionit të saj, kjo është diçka e mirë që do ti shërbej nxënësve dhe gjithë neve, unë jam që të kalojë kjo në kuvend ndërsa pronarë e kësaj toke a dëshirojnë apo nuk dëshirojnë marrëveshje të bëjnë është problem tjetër.

Rasim Fazliu – Edhe unë si kolegët e mi mendojë se është shumë e qëlluar kjo dhe është e nevojshme sepse aty janë me të vërtetë të ngulatur edhe nxënësit por edhe arsimtarët, unë e mbështes plotësisht këtë propozim por vetëm tek çështja se sa ka mundësi komuna të bëjë shpronësimin e kësaj parcele.

Kujtim Popaj - Ky është vetëm hapi i parë që i nevojitet shpallja e interesit të përgjithshëm nga ana e kuvendit, dhe në lidhje me atë se a do të pranohet pala apo jo, pala e ka shprehur një interes një vullnet që është e gatshme mirëpo caktimi i çmimit për këtë pronë nuk është kompetentë kuvendi i komunës por është komisioni i ngritur në kuadër të ministrisë së financave dhe ata e përcaktojnë çmimin, ndërsa sa i përket buxhetit është e paraparë dhe e ndarë një shumë për shpronësim të pronave dhe besoj se do të mjafton.

Kryesuesi - Mendoj se jemi të pajtimit të gjithë dhe e përkrahim këtë propozim të kryetarit të komunës për shpalljen e interesit të përgjithshëm për këtë pronë për nevojat e shkollës fillore Ardhmëria sepse të gjithë e dimë se në çfarë gjendje është kjo shkollë nuk ka mundësi as edhe një veturë ta parkosh sepse nuk ka parking, po ashtu në këtë sipërfaqe në të ardhmen mund të bëhet edhe një ambulancë multi etnike siç është ndërtuar edhe kjo shkollë në ata drejtim, konstatojë që kjo pikë i kalohet kuvendit me përkrahja unanime nga KPF,

4. Shqyrtimi i Propozimit për shlyerjen e borxheve 50% e të gjithë qiramarrësve të pasurisë komunale, është një vendim të cilin e ka propozuar drejtoria për zhvillim ekonomik.

Avdullah Kryeziu – Përsëritet Për të gjithë, Këtë propozim e ka iniciuar drejtoria për zhvillim ekonomik mirëpo edhe nga kryetari i komunës, ky propozim është i bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale të nenit 13,14,58 dhe në statutin e komunës dhe ne si ekzekutiv kemi propozuar që 50% të borxheve të i shlyhen bizneseve që kanë me qira pronat e paluajtshme të komunës, janë shumë faktorë që na kanë shtyrë që me propozim këtë vendim duke e marrë parasysh që gjitha bizneset në komunën e Rahovecit që ballafaqohen me vështirësi serioze që pengojnë funksionim e përditshëm të aktiviteteve të tyre, komuna e Rahovecit nuk ka një fond për mbështetje të bizneseve si komunat e tjera ka një fond minimal që bizneset përkrahen brenda vitit, po ashtu duke u bazuar edhe në kërkesat e bizneseve ku ceken shumë probleme lidhur me të bërit biznes si p.sh krizën në nivel vendi, konkurrenca jo lokale e të bërit biznes, ngritja e pikave të fuqishme në Rahovec si ETC dhe Super Viva, rrënja e fuqisë blerëse të popullatës pra gjithë këta faktorë na kanë shtyrë që ta propozojmë një vendim për faljen e borxheve 50% të bizneseve në komunën e Rahovecit, unë ju kisha propozua juve si KPF që ta shqyrtoni këtë vendim dhe të merrni një vendim i cili do të bënë lehtësimin e të bërit biznes këtyre bizneseve që janë në krizë, i kemi 26 biznese prej tyre 20 biznese janë në proces të ankandit publikë i cili do të përfundon në këtë muaj dhe në muajin e ardhshëm do të bëhet edhe vlerësimi nga komisioni, borxhet e përgjithshme të bizneseve të cilëve ju ka skaduar kontrata janë 63,185.00 € vetëm një operatorë ekonomikë që i ka skaduar kontrata e ka shumën e borxhit 48,450.00 €, ndërsa borxhet e bizneseve që janë me kontratë dhe që kanë kontrata valide janë diku 47,468.00 € dhe gjithsej borxhi i përgjithshëm i bizneseve me kontratë dhe pa kontratë është 110,653.30 €.

Selim Duraku – Ne jemi në një komision dhe në muajin e ardhshëm gjitha këto biznese do të jenë në ankand publikë dhe nga të hyrat e qirasë nga këto biznese komuna nuk ka arritur ti vjelë këto mjete, unë propozoj që të shlyhen këto borxhe 50% por të kenë kusht që 50% të tjera të borxhit ti paguhet komunës, ndërsa tek ai biznese që i ka diku 48,45.00 € borxh propozoj që ti i ketë tjera kritere sepse ti falet këtij 50% e mendoj se është shumë.

Rasim Fazliu – Unë iniciativën kryetarit e përsëritet por të them të drejtën nuk po më Vjen mirë që ka ardhur deri tek kjo pikë që të merret kjo iniciativë sepse nuk është në interes të komunës sepse buxheti i komunës dëmtohet drejtpërdrejtë, ta shfrytëzosh pronën komunale dhe të mos e paguash borxhin nuk e di se si mundet edhe pse nuk i di arsyet se pse nuk kanë arritur ti paguajnë por kjo nuk është e mirë sepse asnjë qeveri deri më tani nuk ka arritur të jenë në nivel detyre dhe ti mbledhin borxhet me kohë që mos të vijmë deri në këtë situatë ku jemi, pajtohem me parafolësin se nëse merret ky vendim të kushtëzohen qytetarët që pjesën tjetër ta paguajnë.

Nënkryetari – Në parim kur ta analizon mirë me të vërtetë është e dhimbshme por janë shumë shkaqe dhe ju kisha lutur juve që të na ndihmoni që ta zgjidhim këtë problem njëherë e përgjithmonë sepse problemet nuk janë grumbulluar prej sodit po as nga dje jo por janë nga fillimi sepse njerëzit kanë rrymë, ujë dhe mbeturina borxh por kjo nuk ka ndodhur pa arsye por sepse ka qenë një propagandë atëherë në fillim se UNMIKU do ti paguaj dhe prandaj ka ardhur deri tek kjo situatë, mirëpo kemi reagime edhe nga ata të ndershmit pra ata që kanë paguar, ka qenë edhe pak neglizhenca e komunës që kemi ardhë deri tek kjo situatë tjetra ka qenë se koha i ka shkelur parimet e mëhershme sepse me hapjen e ETC dyqanet e vogla që mirën me shitblerje ushqimore ju ka ra punë në përgjithësi por ne duhet të bëjmë diçka që të ecë kjo ekonomi, ndonjëherë është shumë vështirë që të xhindet arsyetimi për një zgjidhje por meqenëse ka të bëjë me qira dhe me pronat komunale pra është kategori e cila vendos vetëm kuvendi i komunës atëherë ju lihet juve së bashku me kolegët që janë prezentë ta debatoni dhe të mirëni vendimin e drejtë por me të vërtetë ky problem do të vazhdojë edhe më tutje, kontratat që do të lidhen tash me shfrytëzuesit e rinj le të precizohen gjërat qartë dhe mirë.

Fatmir Iska – Si iniciativë është e mirë mirëpo si bazë nuk është fare mirë, drejtori është dashur të na paraqesë një listë të qiramarrësve dhe jo të flasim përmendësh dhe drejtori e përmendi se diku 110.000 € është borxhi i qiramarrësve që i shfrytëzojnë lokalet e komunës por unë besoj se ky borxh është ma i madh, por sa është e arsyeshme tash që ti hymë në hakë atyre që kanë qenë pagues të rregullt të pronës komunale ata munden të paraqesin kërkesë që edhe ata të kompensohen për atë që kanë qenë pagues të rregullt dhe ti kthehen një pjesë e atyre mjeteve, pe marrë një shembull e kam një kushëri që është pagues i rregullt i lokalit prej mas lufte por çka do i themi ne nesër nëse ai thotë çka fitova unë që jam pagues i rregullt ndërsa ai që nuk është ju e keni amnistuar me 50 %, dhe unë po pyes se sa është e arsyeshme nëse një

qiramarrës që është borxh 70.000-80.000 € dhe i falet gjysma ndërsa ai që ka borxh 1.000 € i falet 5.00 €, në këtë formë të amnistuar si shkojmë ne besoj se edhe në të ardhmen prapo të vazhdoj në këtë ritëm të mos ekzekutimit të këtyre pagesave dhe ata prapë do të thonë se edhe në vitin tjetër prapë mirët vendimi për faljen e borxheve 50%, unë mendoj se nuk duhet të shkohet me këtë formë por duhet të shkohet dhe të diskutohet me ata qiramarrës dhe të shikohet mundësia e shlyerjes së borxheve në format e tjera, unë do isha i pajtimit që të shlyhen borxhet 50 % por jo për gjithë gjiramarësit.

Rexhep Oruçi – Ky vendim ka karakter të përkohshëm pra vetëm për këtë vit, ne i kemi përfshi në vendim kategoritë e shfrytëzuesve të objekteve por unë e di se i kemi edhe disa kategori tjera që janë shfrytëzues të pronave komunale që i kanë ndërtuar objekte në pronat e komunës kemi rastin fabrika e letrës që është rrugës për Suharekë çka do të bëhet me atë kategori, unë mendoj se duhet të ndryshohet titulli i vendimet dhe të përfshihen edhe kategoritë e tjera që të mos i hymë në hakë edhe shfrytëzuesve tjerë.

Kryesuesi – Mendoj se vendimi duhet të jetë më i qartë, këtu thuhet riprogramim i borxheve pajtohem me Fatmirin se është një padrejtësi edhe nëse dekorimi i bizneseve i atyre që kanë qenë qira pagues të rregullt dhe nëse atyre ju hiqet 50% dhe ja lejon mundësin edhe me ja riprogramu borxhin për mu ky nuk është vendim i arsyeshëm, nëse lirohet 50% duhet të jetë vendimi recidivë së pari i paguan 50% të obligimeve të mbetura e pastaj 50% tjera i shlyhen, ndërsa sa i përket atë që tha Rexhepi unë mendoj se kjo kishte me qenë mirë të jetë me një vendim tjetër sepse ndryshojnë sepse aty kemi disa biznese që janë prodhues dhe kanë punëtorë ai ndoshta nuk ka paguar qira por duhet të shikohet se sa ka pas rritje të kapaciteteve të asaj kohe që nuk ka mundur të paguaj qiranë dhe unë jam i pajtimit nëse ai ka arritur të risë kapacitetet prodhuese dhe ta shtojë numrin e punëtorëve pse mos me ja falë atij borxhin komuna sepse interesi i komunës është nëse ai punëson ma shumë punëtor, po ashtu drejtor lista e borxhëlive të i bashkëngjitet vendimit pra vetëm lista e lokaleve afariste të cilat komuna i ka dhanë me qira.

Avdullah Kryeziu – I falënderoj anëtarët e KPF për vërejtjet dhe sugjerimet që i kanë dhanë, Selimi pyeti se a kemi marrë masa, ne brenda vitit 4 herë ju kemi dërguar vërejtje me shkrimë po ashtu edhe fizikisht je kemi tërhequr vërejtjen nëse nuk vije deri tek kjo do të pasojnë edhe gjërat tjera, e ato janë të i grumbullohet borxhi, lënda dhe të ja dërgojmë në gjykatë pastaj tash kemi edhe përmbarues privatë dhe të bëhet inkasimi i dhunshëm, ne nuk kemi dashtë të marrim një iniciativë të këtillë, ka qenë edhe propozim i kryetarit mos të marrim masa rigorozë, ne si drejtori dhe komunë jemi të obliguar ti i ndajmë edhe subvencione bizneseve dhe jo të i vështirësojmë punën atyre, unë ju kuptoj juve sepse e di se ka edhe borxhli të pandershëm por një mase e madhe e tyre ju është vështirësuar kushtet për të bërë biznes, këto borxhe nuk janë që nga viti 2014 këto borxhe janë që nga viti 2008, Rasimi tha se duhet pjesën tjetër ta paguajnë por është normale, ne në vendim e kemi cekur riprogramimin e borxhit ne vetëm kemi propozuar që atyre bizneset që kanë borxhe më të mëdha të i riprogramohet ndërsa te këto kategoritë tjera borxhi është shumë i ulët, unë kam listën këtu nga 26 biznese dhe një pjesë e tyre i kanë shlyer borxhet, por ata që i kanë shlyer borxhet janë ata biznese që e kanë qiranë 50-60 €, por edhe unë jam me kryesuesin që për disa biznese duhet të kemi konsideratë nëse një biznes punëson 10-20 punëtor ne jemi të obliguar edhe ti ndihmojmë dhe që ato biznese ti lirojmë nga qiraja. Po ashtu me të drejtë e tha Rexhepi se ky vendim ka karakter të përkohshëm dhe nuk mundet të jetë permanentë ndërsa për kategoritë tjera drejtoria për ekonomi zhvillim dhe turizëm nuk e ka këtë kategori atë e ka drejtoria për shërbime publike. **Lulzim Sylejmani** - Në raportin financiar ju kam treguar se kemi pas një rritje të inkasimit të qirasë të vitit të kaluar dhe pothuajse e kemi dyfishuar pagesën e qirasë, por problemi është se edhe në nivel qendror që është marrë vendimi për faljen e borxheve nga deri në 2008 edhe ky propozimi i yni që është tash nuk është ardhur me dëshirë sepse kemi vërejtje edhe nga faktori ndërkombëtar dhe fondit monetar për akumulimin e obligimeve që i kemi dhe që i raportojmë çdo vit, obligimet që i kanë qytetarët ndaj komunës së Rahovecit janë 2.4 milion, unë kisha me than që mos të falen një herë borxhet por të dilet me një vendim që të kushtëzohen me pagesën e 50% detyrimisht, ashtu do të jetë edhe me faljen e borxhit nga niveli qendror që ka marrë vendim për faljen e borxhit të gjithë drejtorët e financave në osacion kemi reaguuar dhe e kemi pru kushtëzimin pra propozimi ynë ka shkuar në ministri dhe ministria e ka pranuar që të kushtëzohet me pjesën retroaktive prej 2009 përndryshe nuk do të falen, ka kompani që i kanë shfrytëzuar pronën publike dhe sot kanë ritë shumë kapital, po ashtu ka kompani që paguajnë 10.000 € këstin e kredisë në bankë dhe nuk ka mundësi të paguaj 5.00 € qiranë në muaj.

Kryesuesi – Me një rekomandim që në vendim jo të jetë riprogramim i borxheve 50% por shlyerje e borxheve dhe në kuvend të silltet lista e borxhlinjve që planifikojmë ti shlyejmë borxhin për 50%. Kalojmë në pikën tjetër.

Nëse pajtoheni një pikë të rendit të ditës që e kemi shtyre në mbledhjen e fundit të kuvendit e cila ka qenë Draft rregullorja për organizim të brendshëm kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorive komunale e kemi shtyre sepse kemi pas një paqartësi dhe unë kam kërkuar interpretim ligjor nga MAPL-ja për shkak se me rregullore parashihet një organizim tjetër i kryetarit jo zyrtarë por zyre të veçanta nën përgjegjësin e kryetarit të komunës, po ashtu edhe tek përgjegjësit dhe kompetencat e drejtorive, dhe mu më është kthyer nga MAPL se nuk ka nevojë të ndryshohet statuti për shkak se neni 6 i statutit e sqaron mirë që komuna ka të drejtë të bëjë rregullimin e brendshëm të administratës dhe kjo nuk e shkel statutin e komunës dhe mbasi kemi një afat kohor që deri me 17 prill duhet kjo çështje të rregullohet në nivel komune ne duhet patjetër që në këtë seancë të kemi këtë pikë të rendit të ditës, në KPF e kaluar është shqyrtuar kjo pikë dhe mendoj se edhe ju e përkrahni që ta qesim në mbledhjen e radhës të kuvendit. Po ashtu e kemi edhe një kërkesë të Egzodit 99 që ju ka drejtuar kuvendit të komunës ata kanë kërkuar që ky manifestim të bëhet në Xërxë çdo vit të bëhet nën patronatin e Kryetarit të komunës, k a jeni të pajtimit që këto 2 pika të futen për mbledhjen e radhës të kuvendit, ju falënderoj për mirëkuptim pra edhe këto 2 pika futen për mbledhjen e radhës të kuvendit.

5. Të ndryshme.

Rasim Fazliu – Unë kur kam konkurruar që të bëhem anëtar i kuvendit të komunës e kam pas shkruar se do të jem zëri i qytetarëve dhe do të tentoj të jem zëri atyre aq sa kam mundësi. Flas në emër të qytetarëve të Celinë dhe fshatrave për rreth që janë aty për dy çështje, e para është se disa punë kërkojnë emergjencë dhe jo të lihen deri sa të hapen tenderët sepse vet natyra e punë është që nuk mundet të pritët, është një problem në hyrje të rrugës Fortes –Celinë është bërë një rrëshqitje e dheut unë kam biseduar edhe me drejtorin Fetoshi dhe ai me shpjegoj se duhet tender me hapë komuna, unë kisha me than që ai dhe është dashtë të hiqet brenda dite kur ka ndodhur rrëshqitja. Çështja tjetër është se komuna jonë i ka paguar diku 100.000 € për kullimin e tokave në Celinë, Xërxë dhe Fortes ndërsa tokat tash aty janë bërë liqe njerëzit kanë qitur fara nëpër tokë dhe tokat janë mbushur me ujë, dhe kjo është një neglizhencë sepse ka mundur mos të ketë fare ujë në ato toka, unë atij operatori që i ka kryer punën nuk ja kisha dhanë asnjë cent sepse nuk e ka kryer punën si duhet, mos hapja e përroit të fshatit tek binarët e ka bërë grumbullimin e atij uji. Po ashtu janë disa kërkesa që janë parashtruar nga disa qytetar për furnizim me gypa për kanalizim kishte me qenë mirë që ti dilet zotë të i jepet atyre njerëzve gypat dhe ata e kryejnë vet punën.

Selim Duraku – Kam një pyetje për drejtorin Fetoshi në mbledhjen e kaluar të KPF drejtori pat thanë për një projekt për intervenime emergjente në infrastrukturë do të kryhet brenda një muaji, dhe një muaj janë bërë dhe desha ta pyes drejtorin ku jemi me procedurë.

Rexhep Oruçi - Kam një pyetje për drejtorin Fetoshi çështja e stacionit të autobusëve që 1 vjet jemi duke bërë pyetje dhe nuk kemi kurrfarë përgjigje dhe kurrfarë procedure.

Fatmir Iska – Unë e kam një pyetje për emërtimin e rrugëve a është finalizuar dhe nëse po kur do filloj me vendosjen e shenjave dhe nëse jo ku ka mbet puna. Po ashtu edhe një pyetje e kam për nënkryetarin në këtë komision që kemi qenë Unë, Hazër Tara dhe Qemajl Krasniqi dhe nuk jemi paguar asnjëri mendoj se kjo është shumë e ulët me i anashkaluar anëtarët tjerë vetëm pse janë nga partia tjetër dhe me i hekë nga pagesë, po ashtu unë ju kam drejtuar edhe me një kërkesë me shkrim juve kryesues dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Feim Fetoshi – Përshëndetje për gjithë të pranishmit, Më lejoni që ta përsërisë një çështje procedurale, drejtoritë e caktuara në këtë rast tash drejtoria për shërbime publike ka për detyrë ndjekjen e të gjitha problematikave dhe nga momenti kur ne i përpilojmë projektet apo para masat dhe nga momenti që shkon në zyrën e prokurimit nga ai moment ne nuk kemi asnjë qasje deri në momentin kur zyra e prokurimit na bie në drejtori dokumentin dhe thotë se ky është operatori i ekonomik i kontraktuar që do ta kryej punën, pra kjo është procedura edhe unë kisha pas dëshirë që kjo procedurë të jetë ma e shpejtë por kjo nuk është në kompetencat e mija, dhe Selimi pyeti se ku ka mbet procedura pikërisht dje janë hapur ofertat për tenderin për intervenime emergjente në infrastrukturë dhe unë sot jam takuar me shefin e prokurimit dhe e kam lutur që sa ma shpejtë ajo procedurë të kryhet, kjo përgjigje shkon edhe për Rasimin, dhe po ashtu nëse ka diçka urgjente dhe me rrezik aty është drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, kur ka qenë në kompetencë të drejtorisë së shërbimeve publike edhe pjesa e emergjencave ka pas raste kur kanë qenë vërshimet dhe janë bllokuar rrugët kemi dalë në ora 11.00 ose 1.00 të natës dhe kemi gjet formën për zhblokimin e tyre, por tash nuk është në kompetencën tonë. Sa i përket Celinës që fushat janë të mbushura me ujë aty janë dy problematika, në një është projekti i cili po vazhdon të punojë për kullimin e tokave dhe tjetra është pastrimi i lumenjve, sa i përket pastrimit të lumenjve ne i kemi para masat e gatshme dhe ato janë bukur të shtrenjtë po mundohem që të nxjerri ndonjë fond nga ministria e mjedisit por edhe nëse nga ata nuk fitojmë asgjë do të gjejmë zgjidhje, pjesa e projektit që është duke vazhduar për kullimin e tokave ajo është në kuadër të drejtorisë së bujqësisë, sa i përket paqartësive të projekteve të drejtorisë së shërbimeve publike nga ana qytetarëve unë jam i gatshëm që të shkojë në vendngjarje dhe të ju sqaroj qytetarëve. Sa i përket stacionit të autobusëve unë që nga marsi jam duke u marr me këtë punë dhe ky kuvendë e ka formuar një komision dhe pastaj nga fundi i nëntorit prapë me vendim të këtij kuvendi ai komision është shpërbërë dhe ju ka ndërpre puna këtij komisioni, dhe krejt çka kam mundur të bëjë si drejtor i shërbimeve publike kam pas kontakte të shpeshta me kryetarin dhe e di se kryetari ka marrë një vendim që ti bëhet auditimi i stacionit të autobusëve nuk e di deri ku ka shkuar procedura sepse është në kompetencën e drejtorisë për financa, po ashtu e di se ka ardhur një qarkore nga ministria për shkak të politizimit të çështjes së ligjit për ndërmarrje publike na ka ardhur një urdhëresë që deri sa të vije ligji i ri mos me marrë asnjë procedurë për krijimin e ndërmarrjeve të reja publike.

Rexhep Oruçi – Por për një vit mos me ja nisë asnjë procedurë kjo është e tepërt, komisioni që është formuar ka qenë vetëm në letër sepse ata asgjë nuk kanë bërë njëjtë sikurse ne që nuk jemi në komision, pra thjeshtë përvoja ka munguar por ne kemi në Kosovë komunat që i kanë stacionet në kompetencë qe 5-6 vite, ndërsa ne qe 1 vit nuk po mundemi hasetin tonë ta qesim në binare.

Feim Fetoshi – Unë i mirëpres të gjithë ata që bëjnë pyetje dhe shqetësimi është shumë i drejtë dhe pyetja është shumë e drejtë, ligji e thotë qartë stacioni i autobusëve është 100% aset komunal dhe ka ardhur propozimi që komisioni i aksionarëve duhet ta zgjidhë këtë çështje pra është në duar të kuvendit komunal pra nuk është në duar as të drejtorisë së shërbimeve publike as tek kryetari, pra kuvendi komunal e formon trupin e vetë i cili quhet komision i aksionarëve dhe ai pastaj i jep raport kuvendit.

Kryesuesi –Nëse rruga është e bllokuar qe 1 muaj dhe ti thua se nuk është në përgjegjësin time por ti është dashur ta informosh drejtorin për emergjencë sepse ajo është sapo e formuar dhe drejtorit nuk i bie të kaloj andej dhe ta shoh është mundur të xhindet një bagerr nga operatorët që kanë tender dhe të hiqet ai dhe, ndërsa tek çështja e komisionit të

aksionarëve ajo ka qenë vetëm sa të zhargitet puna dhe në fund ka ardhur një propozim që ne nuk punojmë pa pasur rrogë, dhe ajo që është dashur të bëhet nga ana juaj si drejtori është dashtë të dilni me një propozim se çka duhet të bëhet me stacionin e autobusëve dhe ne kishim marrë ndonjë vendim në kuvend dhe e kishim autorizuar kryetarin që ta qesë ndonjë udhëheqës të përkohshëm në ata stacion.

Feim Fetoshi – Ti je duke folur ashtu si të bije për shtati ty ndërsa unë jam duke folur zyrtarisht në KPF, pra kompetencë ekskluzive është e kuvendit komunal.

Rasim Fazliu – Ne jemi duke diskutuar për interes të qytetarëve dhe nuk është mirë të acarohet situata, por për çështjen e stacionit të autobusëve me të vërtetë problemi është tek kuvendi komunal unë personalisht mendoj dhe arsyeja është kjo sepse dy anëtarët e kuvendit e kanë bllokuar komisionin sepse kanë thanë se nuk punojmë pa na paguar, ne është dashur si kuvend me i zëvendësuar këta dy anëtar me anëtar tjerë sepse nëse nuk dëshirojnë ata të punojnë do të punon dikush tjetër dhe do të ishte zhbllokuar puna.

Kryesuesi – Për pagesën e anëtarëve të komisionit për emërtimin e rrugëve që e përmendi Fatmiri unë kam biseduar dhe ata janë duke u arsyetuar me faktin se ju keni qenë në ekzekutiv në të kaluarën dhe për atë arsye nuk ju takojnë, por unë prapë do të bisedoj me kryetarin dhe besoj se do të kryhet kjo punë.

Avdullah Kryeziu – Rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba është miratuar në kuvendin komunal me 31 janar dhe sipas ligjit ne e kemi dërguar rregulloren tek komisioni për vlerësimin e ligjshmërisë, kemi marrë disa vërejtje në disa tarifa që bijën në kundërshtim me ligjet qendrore dhe ne e kemi bërë përmasimin, po ashtu sot sa më erdh një vlerësim të ligjshmërisë që e kanë bërë ata gabimisht, pra unë kërkoj nga ju kryesues që nëse na vjen konfirmimi se çdo gjë është në rregull edhe një herë të Vjenë në kuvend rregullorja.


Kryesuesi - Unë kam kërkuar prej fillimit nga drejtorë që secili të rijë në kontakt me qendrën për shkak të mos gabojnë në mënyrë që kur ta aprovojmë në kuvend mos të na rikthehet prapë, dhe ende komuna jonë punon me rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba të vitit 2011.

Fatmir Iska – Në lidhje me stacionin e autobusëve ne e kemi pranuar si kuvendë një raport prej atij komisionit të aksionarëve për gjitha punët mirëpo asnjë veprim ma tutje nuk është ndërmarr dhe nuk munden neve të na bllokojnë 2 anëtar të kuvendit, meqenëse ajo është trajtuar edhe në KPF edhe në Kuvend drejtori le të përgatitet në seancën e kuvendit le ta parasheh një pikë të rendit të ditës ku do të bëhet ndryshimi i atij komisioni dhe le të propozohen dhe të futen anëtarët e rinj dhe le të vazhdojë puna aty ku ka mbet dhe le të kryhet puna ashtu si i ka hije dhe të merret një vendim që të vendoset një drejtor ekzekutiv i përkohshëm dhe anëtarët e bordit kush do të jenë dhe le të kthehet ajo ndërmarrje në pronën komunale.

Mbledhja ka përfunduar në ora **12.40**.

Procesmbajtësi,
Skender Hamza

Kryesuesi
Nahit Elshani



-III- Nr. i prot. 2108 Më Dt. 13.03 20 15
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC